

328 SHËNIMI PËR DISERTACIONIN (TEZËN)

Fusha përmban shënimin që tregon se njësia është disertacion ose tezë.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
328	Shënimi për disertacionin (tezën)	r
a	<i>Teksti i shënimit</i>	nr
d	<i>Viti i mbrojtjes</i>	nr
e	<i>Viti i marrjes së gradës*</i>	nr
f	<i>Grada shkencore*</i>	nr
g	<i>Fusha e shkencës*</i>	nr

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

328a Teksti i shënimit

Shënimi për disertacionin ose tezën. Zakonisht shënohet institucioni që jep gradën.

328d Viti i mbrojtjes

Data e mbrojtjes së disertacionit të doktoratës (viti, mund të shënohet edhe muaji dhe dita).

328e Viti i marrjes së gradës*

Data e marrjes së gradës (viti, mund të shënohet edhe muaji dhe dita).

328f Grada shkencore*

Grada shkencore pas përfundimit të studimeve pasuniversitare për marrjen e gradës doktor i shkencave, p.sh. dr. i shkencës, dr. i shkencave matematike (shih shembujt 2, 3).

328g Fusha e shkencës*

Fusha e shkencës në të cilën merret grada shkencore, p.sh. biologjia, sociologjia (shih shembujt 2, 3).

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

105b MATERIALI TEKST MONOGRAFIK, Kodet për llojin e përmbajtjes

Nënfusha përmban kodin që tregon llojin e përmbajtjes. Disertacionet e doktoratave përmbajnë kodin "m" ose "mb31".

SHEMBUJ

1. * COBISS.net

200	0□	a Patologjitë e zemrës f Drilon Ajeti
328	□□	a Disertacion, Univ. i Mjekësisë, Prishtinë <i>(Në fushën 200 nuk ka të dhëna se njësia është disertacion doktorate, për këtë arsye kjo e dhënë vendoset në shënime.)</i>

2. * COBISS.net

200	0□	a Mitologjia në letërsinë moderne shqipe e disertacion f Andin Lokaj
328	□□	a Univ. i Tiranës, Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Letërsisë Moderne Shqipe d 20010309 f dr. i shkencës g letërsia moderne shqipe <i>(Në fushën 200 ndodhet e dhëna se njësia është disertacion, për këtë arsye kjo e dhënë nuk është e nevojshme të vendoset edhe në shënime.)</i>

3. * COBISS.net

328	□□	a Univ. Politeknik i Tiranës, Fak. i Teknologjisë së Informacionit, Departamenti i Inxhinierisë Informatike d 2002 f dr. i shkencave informatike g teknologjia
-----	----	--